

LIGJ
Nr. 93/2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 35/2023, “PËR KOMPETENCAT PËR
CAKTIMIN E PAGAVE, TRAJTIMEVE TË TJERA FINANCIARE DHE
PËRFITIMEVE TË TË PUNËSUARVE NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS
PUBLIKE, SI DHE TË PAGËS BAZË MINIMALE NË SHKALLË VENDI”**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Neni 1

Në nenin 9, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) shpërblimin mujor të kryetarëve të fshatrave në masën deri në 10 për qind të pagës mujore të kryetarit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore.”.

Neni 2

Dispozitë kalimtare

Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji, fillojnë nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.7.2024.

Shpallur me dekretin nr. 307, datë 8.8.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.